

### THIRRJE PËR PROPOZIME

Ide kreative për intervenimeve artistike në Prizren

EC Ma Ndryshe fton personat e interesuar të aplikojnë me ide kreative për realizimin dhe ekzekutimin e veprave (intervenimeve) artistike në hapësirën publike të qytetit të Prizrenit. Intervenimet duhet të realizohen në hapësirë publike, dhe autorët mund të përdorin cilëndo formë të shprehjes artistike (kreative). Intervenimet duhet të artikulojnë një ose më shumë çështje (shqetësime) publike të qytetit të Prizrenit dhe të ekzekutohen në bashkëpunim me komunitetin (kryesisht nxënësit dhe studentët).

Intervenimet artistike në hapësirë publike zhvillohen që të tërheqin vëmendjen e publikut dhe institucioneve të shtetit për problemet aktuale të qytetit përmes metodave të të shprehurit kreativ. Temat e mundshme për t'u trajtuar nga këto intervenime janë: degradimi urban, shkatërrimi i trashëgimisë kulturore, zaptimi i hapësirës publike, demokratizimi, të drejtat e njeriut, diskriminimi, etj.

Për të aplikuar me ide kreative për intervenime artistike në hapësirën publike të qytetit të Prizrenit duhet të plotësoni formën e aplikimit e cila shkarkohet në linkun [www.ecmandryshe.org/konkurse](http://www.ecmandryshe.org/konkurse) dhe të dërgoni atë në email adresën [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org) deri më 30 qershor 2014, në orën 17.00. Në mesin e aplikimeve do të përzgjedhen tri ide më të mira, të cilat do të realizohen dhe zbatohen nga bartësit/autorët e ideve gjatë pjesës së dytë të vitit 2014. Përzgjedhjen do ta bëjë komisioni vlerësues i përbërë nga tre anëtarë, një nga EC Ma Ndryshe, një nga Ambasada Amerikane në Prishtinë dhe një nga komuniteti artistik i Prizrenit.

Secila nga tri idetë fituese do të shpërblehet me 1000 dollarë amerikanë, mjete këto që duhet të përdoren për realizimin e veprave (intervenimeve) artistike. Idetë fituese do të publikohen në web-faqen e organizatës ([www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org)), ndërsa EC Ma Ndryshe do t'i ftojë autorët e ideve fituese për t'i diskutuar detajet e realizimit të intervenimeve (koha, vendi, përfshirja e komunitetit, aspekte financiare, etj.).

Ky konkurs është pjesë e projektit "Aktivizmi kulturor dhe urban në Prizren" që ka filluar të zbatohet në prill 2014 nga EC Ma Ndryshe, me përkrahje financiare të Ambasadës Amerikane në Prishtinë. Projekti është i ndërtuar mbi botëkuptimin se arti dhe artistët janë agjentë të ndryshimeve në shoqëri. Projekti synon nxitjen e debatit shoqëror mbi rolin e aktivizmit kulturor në transformimin urban të qytetit. Në esencë, projekti është një iniciativë e intervenimit kulturor dhe artistik që i trajton në mënyrë kreative sfidat aktuale të zhvillimit urban dhe reformës demokratike në Prizren.

*Projekti "Aktivizmi kulturor dhe urban në Prizren" financohet përmes grantit të Ambasadës Amerikane në Prishtinë.*

